



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpcë

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce

01/Br.Prot.	IZLAZNI - DALËSE
Nr.Prot.	01-020108-1075/21
Br.str.	/
Nr.i fq.	
Datum	29.01.2021
Data	
ŠTRPCE - SHTËRPÇË	

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 28/01/2021 miratoi këtë :

### V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 29.12.2020

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpcë  
Komuna e Shtërpçës  
Municipality of Strpce



REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIQUE DU KOSOVË  
KOMUNA E SHTËRPÇËS

01/Br.Prot. IZLAZNI - DALËSE  
Nr.Prot. 01-020108-1075/21  
Br.str. /  
Nr.i fq.  
Datum 29.07.2021.  
Data ŠTRPCE - SHTËRPÇË

## PROCESVERBAL

Nga seanca e tetë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 29.12.2020, me fillim në ora 10:00

### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së së Shtërpçës
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e jashtëzakonshme e KK Shtërpce
4. Aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2021
5. Të ndryshme

### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

**Predrag Grbic:** Të nderuar nënkyetaret, këshilltar, të respektuar koleg këshilltar, drejtoret e drejtorive, media dhe të gjithë të tjera të pranishëm. Mirëdita dhe mirë se vini në seancën e tetë të rregullt të K.K. Shtërpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm 15 këshilltarë, dhe mund të fillojmë me rendin e ditës, A lajmërohet dikush përfjalë? Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua rendin e ditës

### 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluare KK Shtërpce

**Predrag Grbic:** A lajmërohet dikush përfjalë? Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua procesverbalin

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e jashtëzakonshme e KK Shterpce**

**Predrag Grbic:** A lajmërohet dikush për fjalë? Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua procesverbalin nga seanca e jashtëzakonshme KK Shterpce

### **4. Aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2021**

**Predrag Grbić:** Ju e dini që nuk ekziston një plan perfekt, por ne u përpoqëm të realizonim të gjitha që ishin paraparë në planin e punës së Kuvendit. Ne gjithashtu patëm probleme për shkak të virusit, por gjithsesi arritëm të realizojmë pjesën më të madhe të asaj që kemi planifikuar. Sa i përket planit për vitin e ardhshëm, ne kemi vendosur pika që ne e dimë se sigurt duhet të gjenden për vitin e ardhshëm, ato që kërkojen nga ligji të jenë në planin e punës për vitin e ardhshëm. Sapo jemi takuar me anëtarët e komisionit dhe kemi rënë dakord që nëse e dimë në periudhën e ardhshme se çfarë mund të jetë në rend të ditës, ne do të plotësojmë Planin e Punës të Kuvendit për vitin e ardhshëm.

**Rifat Rustemi:** Sa i përket planit, nuk do të kisha asgjë për të shtuar, ne e dimë që mund ta shtojmë ose ndryshojmë, por unë kam një vërejtje për periudhën e kaluar dhe një sugjerim për periudhën e ardhshme, nëse ka mundësi. Këtë vit, kemi pasur shumë pika që janë futur 5 minuta para Kuvendit dhe nuk kemi pasur mundësi ta shqyrtojmë si duhet atë pikë dhe kish dashur të miratojmë. Unë kisha kërkuar që të mos praktikohet kjo në vitin e ardhshëm, mund të ndodhë përsëri, por jo aq shpesh. Ka ndodhur që në një seancë të kishim dy pika shtesë 5 minuta para fillimit të seancës dhe nuk e dinim për çfarë bëhej fjalë, të paktën një ditë më parë të marrim materialin kur duhet të shqyrtohet për të ditur se për çfarë bëhet fjalë dhe me dit ame miratu, ose jo.

**Predrag Grbić:** Situata ishte e tillë që na u desh të bëjmë ashtu, sepse komuna ka punuar me kapacitet të zvogëluar dhe të gjithë jemi munduar që ta bënim punën sa më shumë në kushtet që kemi pasur dhe sigurisht që do të praktikojmë që të mos jemi në një situatë të tillë në vitin e ardhshëm. A lajmërohet dikush tjetër fjalës? Askush nuk po lajmërohet, e vë këtë pikë në votim.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua këtë pikë

### **3. Të ndryshme**

**Garip Sahiti:** Mendova se në këtë seancë do të këtë një raport nga shtabi e krizës kur bëhet fjalë për virusin, në mënyrë që të ishim të njoftuar se si u zhvillua e gjithë situata në të cilën jemi tanë jemi tanë. Tani ne e dimë që sezoni i skijimit është i hapur, dhe ajo paraqet një problem i madh

për komunën tonë, teleferikët kanë filluar punën, turistët po vijnë nga komunat e tjera ku ka një numër të madh të infektuarve, kështu që ne mund të rrisim numrin e sëmurave në komunë, sepse qendra e skijimit më shumë përngjon në një treg sesa një qendër të vërtetë të skijimit. Ëhtë për të ardhur keq në çfarë gjendje është tani qendra e skijimit, ka shumë mbeturina, ka shum njerëz. Meqenëse na nuk jemi pjesë e shtabit të krizës, unë po kërkoj që të merren masa të reja, që teleferiku të ndalet dhe vizitat nga komunat e tjera të ndalojen.

**Rifat Rustemi:** Jam plotësisht dakord me nënkyetarit e kryesuesit, kjo është e vërtetë. Sa i përket mjedisit në komunën tonë, ne e dimë që është një mjedis i pasur, të paktën ka qenë më parë, nuk e di a është ende, nuk mund të pretendoj. Me ndërtimin e hidrocentraleve, janë shkatërruar pyjet. Ne e kemi bërë vetë ato në 10-15 vitet e fundit. Ekzistojnë deponi ilegale dhe mendoj se do të ishte mirë të merren disa masa kur bëhet fjalë për mjedisin, ne dojm të jemi të njëjtë me komunat e Prishtinës dhe Ferizajt, për ta bërë komunën e Shtërpcës një zonë urbane.

**Predrag Grbić:** Nuk do të pajtohna me atë që z. Garip ka thënë, sepse për këtë ka një mijë arsy. Më habit se ai nuk ka pasur një reagim të tillë kur epidemia e koronës ishte më e madhe, sa që nuk ka kërkuar ndalimin e njerëzve që vijnë nga zona tjera në zonën e vikendiceve. Ne kemi një zonë vikendiceve ku të gjithë njerëzit janë nga zona të tjera dhe jo nga komuna e Shtërpcës, por kjo është një e drejtë njerëzore, ju nuk mund ta kufizoni lëvizjen e dikujt pa ndonjë arsy. Nëse ka një kufizim të lëvizjes, karantina ka shërbime që janë përgjegjëse për këtë, ka pasur ora policore, pastaj karantina, etj. Ky është një mjedis që ka jetuar nga turizmi, ne e dimë që situata ekonomike është e vështirë, dhe nëse do të vinim në një situatë ku qendra e skijimit nuk funksionon fare, komuna jonë do të ishte në një situatë ekonomike edhe më të keqe sesa është. Unë nuk jam duke thënë që qendra e skijimit duhet të funksionojë, por po them që ka organe që do të monitorojnë situatën me koronën dhe do të marrin një vendim nëse qendra e skijimit a do të funksionojë apo jo. Vitin e kaluar, qendra e skijimit ka punuar, dhe kur ka filluar situata me kurorën, kanë ardhur autoritetet kompetente dhe qendra e skijimit ka ndaluar punën. Ne nuk mund të marrim vendim nëse do të ndalojmë dikë të vijë në komunën tonë, ne kemi kompetenca të tjera, por nuk mund ta ndalojmë dikë të vijë në komunën tonë. Unë besoj në organet që monitorojnë situatën me koronën në tërë Kosovën se ata do të monitorojnë edhe qendrën e skijimit, dhe nëse ekziston një mundësi të përhapjes së infeksionit, unë jam i sigurt që qendra e skijimit do të mbyllët. Dhe sa i përket mbeturinave, është një katastrofë, unë shpesh shëtis në natyrë dhe ajo që kam pasur rastin të shoh është e tmerrshme. Bëhet fjalë për vetëdijen e të gjithëve ne, të gjithë kemi faj për të gjitha ato. Në komuna të caktuara ka gjoba të caktuara për ndotje e mjedisit, ne duhet të votojmë këtu në Kuvend për gjobat për ato shkelje dhe ai që regjistron dikë që hedh mbeturina me dëshmi duhet me ardh në komunë, dhe ai që ka hedhur mbeturinat ndëshkohet dhe ai që ka bërë fotografi merr një shpërblim. Kështu që duhet të të gjenim një zgjidhje të ngjashme për të penguar këtë.

**Sasa Krsticic:** Ne e bëjm teste të rregullta, tri herë në javë dhe në ditët e fundit ka pasur një rënie të numrit të njerëzve të infektuar. Tani kemi 29 pacientë pozitivë, 20 janë shëruar dhe kemi 10 pacientë që ndodhen në spital, fatkeqësisht kemi pasur edhe 5 vdekje, kryesisht persona me sëmundje kronike. Ndryshtë nga vala e dytë, situata tani është relativisht e qëndrueshme. Unë mendoj se trendi i pacientëve ngadalë do të bjerë, tani jemi në javën e shtatë. Ne po monitorojmë nga afër situatën, po dërgojmë të gjithë pacientët e dyshimtë për testim. Ka më shumë negativë të testuar sesa pozitivë, por ka akoma pozitivë, kështu që ne duhet t'i përbahemi të gjitha masave, dhe unë jam optimist se nëse festat e Vtit të Ri shkojnë ashtu siç duhet, për t'u festuar pa u grumbulluar, situata do të jetë më mirë. Njerëzit po sillën me shumë ndërgjegje dhe besoj se situata do të përmirësohet dita ditës.

**Garip Sahiti:** Më lejoni të ndërlidhem sa i përket Brezovicës. Unë e di që na nuk mund të pezullojmë punën e qendrës së skijimit sepse është në interes të qytetarëve tanë, por unë e di që është e ndaluar që të grumbullohen më shumë se 8 persona. Për momentin atje nuk ka skijim, ka shumë njerëz që mblidhen dhe nuk e mbajnë distancë atje. Dhe kur bëhet fjalë për skijim, atëherë situata është pak më ndryshe, njerëzit bëjnë skijim dhe nuk do të ulen pranë njëri-tjetrit. Unë dhashë një deklaratë në televizion, për të qenë në kontakt shtabi e krizës me nivelin qendror, me policinë për të ndaluar mbledhjen e njerëzve. Ekziston edhe një zonë e vikendiceve, siç tha kryesuesi, dhe për atë pjesë kam dekluar se edhe ata gjithashtu bërë probleme dhe ata kanë krijuar ato deponi ilegale, të gjitha këto janë probleme kur bëhet fjalë për komunitetet serbe dhe shqiptare. Ka deponi në Coklar, fshati Brod, dhe askush nuk po reagon lidhur me këtë, ne duhet të formojmë një kompani të fortë që do të kujdeset kur bëhet fjalë për deponitë. Nëse ne nuk e shpëtovjmë mjedisin tonë, kush tjetër do ta shpëtojë.

**Rifat Rustemi:** Nëse ka një mundësi që vitin e ardhshëm të lexoni pak për ligjet se sa kemi të drejta na dhe sa nuk kemi, për të praktikuar atë mënyrë të dënimit të atyre që hedhin mbeturina, mendoj se kjo është një ide vërtet e mirë. Të shpërblehen ata njerëz që bëjnë fotografi dhe regjistrojnë dhe të denohen ata që hedhin mbeturina. Ne mund, për shembull, ta gjobisim dikë me 50 euro, dhe aty duhet të ketë një dallim, sepse dikush e hedh një kanaçe ose dikush që hedh një kamion plot mbeturina. Të kemi dënlime të ndryshme. Le të themi se dikush që hedh një kamion të mbushur me mbeturina gjobitet me 100 euro, dhe ai që e fotografon të shpërblehet me 50 euro.

**Predrag Grbić:** Sapo kam marrë këtë ligj për vetëqeverisjen lokale. Një nga kompetencat e vetëqeverisjes lokale është mbrojtja e mjedisit, kështu që ne kemi të drejtën e plotë për të luftuar për të mbrojtur mjedisin, dhe ekziston një ligj që ne si Kuvend mund të votojmë për disa gjobat për disa shkelje të tilla. Unë e kuptoj shqetësimin tuaj, z. Garip, ne nuk u kuptuam pak kur e keni thënë qëndrimin juaj për qendrën e skijimit, Ju nuk jeni për me parandaluar punën e qendrës së skijimit, por me zbatim të rreptë të të gjitha masave. Pasi askush nuk po lajmërohet për fjalë, unë do të kisha shfrytëzuar këtë rast për të uruar të gjithë këshilltarëve dhe të gjithë qytetarët një Vit të Ri të suksesshëm, mbi të gjitha ju uroj shëndet dhe që të gjitha dëshirat tuaja të bëhen realitet.

Procesmbajtësi  
Staja Markovic

